

**KONTRATË SHITESË KONCESIONI  
PËR**

**DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”  
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) Nr.2183 Rep., Nr.1145/1 Kol., datë 16.10.2018  
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “ZALL XHUXHE NR 1” & “ZALL  
XHUXHE NR.2” E NDRYSHUAR.**

Në Tiranë, më datë 24, muaji Janor, viti 2022 (dymijë e njëzetë e dy), para meje noter Gentiana Masi, anëtar i dhomës së Noterisë Tirane, me adresë Gjegje Fish të, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar nga Z. Ilir Bejtja, i datëlindjes 17/01/1966, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim me Nr. \_\_\_\_\_ dhe nr. Personal ID \_\_\_\_\_

**DHE**

**Shoqëria Koncesionare “HEC ZALL XHUXHE” sh.p.k**, themeluar si person juridik datë 13.09.2013 dhe regjistruar në QKB datë 01.10.2013, me NUIS L322010370, e përfaqësuar nga Z. Ender Boçi, shtetas shqiptar, i datëlindjes 02.05.1968, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga Letërnjoftim me Nr. \_\_\_\_\_ dhe nr. Personal ID \_\_\_\_\_

**të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:**

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim – Transferim), me Nr. 10329 Rep., Nr. 3323 Kol., lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoriteti Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gloris Construction” sh.p.k dhe “Gjoka Construction” sh.p.k për ndërtimin e hidrocentraleve “Zall Xhuxhe Nr.1” dhe “Zall Xhuxhe Nr.2”, hyrë në

**Duke pasur parasysh që:**

- Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoriteti Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Gloris Construction" sh.p.k dhe "Gjoka Construction" është lidhur Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" (Ndërtim – Operim – Transferim), me Nr. 10329 Rep., Nr. 3323 Kol., për ndërtimin e hidrocentraleve "Zall Xhuxhe Nr.1" dhe "Zall Xhuxhe Nr.2", hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 09.09.2013; e ndryshuar:

- Ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues) dhe shoqërisë koncesionare "Hec Zall Xhuxhe" sh.p.k. është lidhur Kontrata Shtesë e Koncesionit me Nr. 575 Rep., Nr.248/2 Kol., datë 19.03.2018 "Për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të Formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Zall Xhuxhe Nr.1" dhe "Zall Xhuxhe Nr. 2"

- Referuar shkresës së shoqërisë koncesionare "Hec Zall Xhuxhe" sh.p.k. protokoluar në MIE me Nr. 8346 Prot datë 18.11.2021 me anë të së cilës ka paraqitur kërkesën për shtyrjen e afateve të programit të punimeve në pamundësi të përfundimit brenda afateve të përcaktuara në kontratën e koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "Zall Xhuxhe Nr.1" dhe "Zall Xhuxhe Nr. 2", si pasojë e pandemisë të Covid 19 duke e konsideruar rastin si Forcë Madhore.

- Referuar shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti Kontraktues), me Nr. 8346/2 Prot., datë 24.12.2021 "Këhim përgjigje", drejtuar shoqërisë koncesionare "HEC ZALL XHUXHE" sh.p.k mbi miratimin e shtyrjes së programit të punimeve për shkak të pandemisë të Covid 19 duke e konsideruar rastin si Forcë Madhore dhe ku shoqëria duhet të paraqesë Programin e Punimeve të përditësuar me afatet e reja për ndërtimin e hidrocentraleve.

- Mbështetur në nenin 28 "Ndryshime" të Kontratës së Koncesionit, ku në pikat 28.1 dhe 28.2, cilësohet se:

28.1. *Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime me marrëveshje me shkrim të palëve;*

28.2 *Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur, pasi të hyjë në fuqi do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate; si dhe;*

- Në nenin 29 "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit", të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;

2013 Në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) me Nr.575 Rep., Nr.248 Kol., datë 19.03.2018  
2018. Rep., Nr.3023 Kol., lëshuar ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës (Autoriteti Kontraktues) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqëriave "Gloria Construction" sh.p.k dhe "Gjoka Construction" sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve "Zall Xhuxhe Nr.1" dhe "Zall Xhuxhe Nr.2", hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 09.09.2013 e ndryshuar me Kontratën Shtesë të Koncesionit me Nr.575 Rep., Nr.248 Kol., datë 19.03.2018 "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Zall Xhuxhe Nr.1" dhe "Zall Xhuxhe Nr.2" të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

### Neni 1

Neni 10 "Programi i punimeve", pika 2 ndryshohet si më poshtë:

Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate Shtesë të Koncesionit të formës "BOT" (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve "Zall Xhuxhe Nr. 1" dhe "Zall Xhuxhe Nr.2".

### Neni 2

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

### PALET

**AUTORITETI KONTRAKTUES**

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**

**Përfaqësuar me Autorizim Nr.201 , datë 11.01.2022  
të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga:**

**Z. Ilir Bejtja**

**SHOQËRIA KONCESIONARE**

**"HEC ZALL XHUXHE" Sh.p.k.**

**Përfaqësuar**

**Z. Ender Boçi**